

VENDIM
Nr. 154, datë 30.6.2021

MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 436, SERIA TGN19, PËR AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR, DHËNË TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 15, DATË 31.1.2019

Në mbështetje të nenit 4, pika 50, nenit 23, pika 1, germa “a”, dhe nenit 35, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 5, të nenit 9, pika 2, germa “a”, “x”, të nenit 9, pika 2, germa “a”, “xvii”, si dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.6.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 96/4 prot., datë 24.6.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria e Gazit Natyror

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 121, datë 11.5.2021, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës nr. 436, seria TGN19, për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë Trans Adriatic Pipeline AG (TAP AG) me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.1.2019, për ndryshimin e afateve të kohëzgjatjes së saj nga 25 vjet në 30 vjet.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit, më datë 23.6.2021, të përcaktuar në nenin 10, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga TAP AG.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 596/2 prot., datë 14.6.2021, TAP AG ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e munguar të konstatuar nga aplikimi i saj.

- TAP AG ka kryer për llogari të ERE-s pagesën përkatëse për modifikimin e licencës në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017.

- Referuar kërkesës së TAP AG për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së licencës së saj për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, vlen të theksohet se përjashtimi nga kërkesat e nenit 9, pika 2, germa “a”, “x”, si dhe nga kërkesat e nenit 9, pika 2, germa “a”, “xvii”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, do të jetë vetëm për 25 vjet, referuar dhe Opinionit të Përbashkët Përfundimtar (*Final Joint Opinion*) dhe përjashtimit të kushtëzuar të TAP AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC, për projektin Trans Adriatic Pipeline, miratuar me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013, të Bordit të ERE-s:

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën përfundimtare të procedurës së modifikimit të licencës së TAP AG, për sa i përket kohëzgjatjes së saj, rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, si më poshtë:

- Neni 13, pika 4:
- a. tekstin e propozuar të ndryshimit specifik që është kërkuar, plotësuar;
 - b. informacion me shkrim që shpjegon arsyet e kërkesës për ndryshim të licencës, plotësuar;
 - c. vendimin e shoqërisë ose çdo dokument tjetër që vërteton kërkesën e të licencuarit për ndryshimin specifik të licencës, plotësuar.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.1.2019, “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e regjistruar pranë QKB-së, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG”, ndryshon si vijon:

Ishte:

1. Të licencojë në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror Trans Adriatic Pipeline AG Albania, të regjistruar pranë QKB-së si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG, për një afat 25-vjeçar, nga data e fillimit të operimit.

Bëhet:

1. Të licencojë në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, Trans Adriatic Pipeline AG Albania, të regjistruar pranë QKB-së si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG, për një afat 30-vjeçar, nga data e fillimit të operimit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojnë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti